



RENOFIX 700

LLAÇ MINERAL STRUKTURAL
(ABRIB) PËR MURE

Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik!

HAPËSIRAT E PËRDORIMIT:

Material mineral ndërtimi për banim komod dhe të shëndetshëm .Renofix 700 është material bashkëkohor ndërtimi me cilësi të larta. Llaç mbështjellës mineral-struktural për sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme , mbi llaçe themelore apo plysterol,që paraprakisht janë përpunuar me Renofix 18 ose Renofix 5 I bardhë.

PËRMBAJTJA:

- Gëlqere e hidratizuar
- Çimento e bardhë
- Rërë e bardhë mermeri

VEÇORITË::

- Ngjyrë të bardhë me shkëlqim
- Cilësi të shkëlqyer të përpunimit
- Llaç final me strukturë të përsosur
- Ekologjikisht i preferuar

PËRGATITJA E BAZËS:

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastruar nga pluhuri. Renofix 700 mund të përdoret mbi llaçet themelore (gëlqere, çimento dhe gips) pasi të jenë tharë plotësisht. Të gjitha bazamentet, pllakat e gipskartonit apo sipërfaqet e lëmuara të betonit duhet paraprakisht të rrafshohen mirë me Renofix 5 i bardhë / Renofix 18 ngjitës ndërtimi..

PËRGATITJA E LLAÇIT:

Një thes Renofix 700 zbrazet në 6.3-6.7 litra ujë të pastër dhe përzihet me mikser deri sa të fitohet masë homogjene. Pas 10 minutave, duhet përzier sërish.

PËRPUNIMI DHE K U S H T E T E PËRPUNIMIT:

Llaçi vendoset me rrafshues metali që nuk ndryshket (gletkele).Strukturimi i llaçit arrihet me fërkuese nga stiropori apo plastika. **Nuk lejohet përdorimi në temperaturë nën +5°C.** Nuk lejohet përzjerja me materiale tjera.



VËREJTJE:

Përmban gëlqere të shuar dhe çimento të bardhë. Irriton sytë dhe lëkurën. Në raste të tilla, lëkura të lahet me ujë të pastër, ndërsa për sytë kërkoni ndihmën e mjekut.

PAKETIMI:

Renofix 700 paketohet dhe shpërndahet në thasë letre nga 25 kg. që janë të mbrojtur nga lagështia. 

DEPONIMI:

Të deponohet në hapësira të thata, mbi paleta të drurit. Afati i deponimit është 6 muaj.

Të dhëna teknike	
Numri i prodhimit:	5319990620231
Shifra e prodhimit:	1701 1701,5 1702 1703
Thasë në paletë:	42
Sasia e nevojshme e ujit:	6,3-6,7 l./Thes


RENOFIX 700

Granulacioni:	1 mm	1,5 mm	1,5 mm	2 mm	2 mm	3 mm
Struktura e materialit dekorues	R	R	V	R	V	R
Ngjyra	E BARDHË					
Harxhimi:	11 - 12 m ² /EH	10 - 11 m ² /EH	10 - 11 m ² /EH	8 - 9 m ² /EH	8 - 9 m ² /EH	6 - 7 m ² /EH
	2 - 2,1 kg/m ²	2,2 - 2,6 kg/m ²	2,2 - 2,6 kg/m ²	2,8 - 3,2 kg/m ²	2,8 - 3,2 kg/m ²	4 - 5 kg/m ²
Shënim:	Vlerat e harxhimit janë aproksimative (të përafërta) dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit.					
Dendësia e materialit kur është i thatë	ca. 1400 kg/m ³					
Përçueshmëria e nxehtësisë (EN 1745:2002):	ca. 0,54 W/mK					
Kapaciteti i veçantë i nxehtësisë:	ca. 1 J/kgK					
Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11):	ca. 1,0 N/mm ²					
Absorbimi i ujit (EN 1015-18):	< 0,2 kg/m ² h					
Reagimi gjatë djegjes (EN 13501-1):	A 1					
MG (EN 998-1):	GP CS I W1					

Udhëzime të përgjithshme:




Me këtë listë të gjitha të dhënat e mëparshme për materialin bëhen të pavlefshme. Këto të dhëna janë të vlefshme për testimet tona të tanishme. Nga këto të dhëna nuk mund të dalë detyrim juridik. Prodhimet RENOVA, si dhe të gjitha lëndët e para përbërëse janë gjithmonë nën kontroll të vazhdueshëm me qëllim të ruajtjes në vazhdimësi të cilësisë së njejtë. Konsulentët tanë teknik janë gjithmonë në disponimin tuaj në lidhje me punën, përdorimin dhe prezantimin e prodhimeve tona. Gjendjen aktuale të të dhënave teknike mund ta gjeni në ueb faqen tonë: www.renova.com.mk si ose mund t'i kërkonit në sektorin e shitjes.



- 1 RENOFIX 5
- 2 Stiropor ose lesh mineral
- 3 Diblla për stiropor
- 4 RENOFIX 5 I BARDHË
- 5 Rrjetë për armim
- 6 RENOFIX 5 I BARDHË
- 7 RENOFIX 700-1,2,3. mm

MUR ME
TERMOIZOLIM



- 1 RENOFIX 10
- 2 RENOFIX 18
- 3 RENOFIX 700

MUR PA
TERMOIZOLIM

RENOVA PUTZ | www.renova.com.mk

RENOVA Xhepçisht, Tetovë, Maqedoni | Tel.: 044 487 300 | Fax: 044 487 200 | info@renova.com.mk
 RENOVA Gurëza, Ferizaj, Kosovë | Tel.: 00381 290 323 311 | Fax: 00381 290 396 396 | renova_ferizaj@hotmail.com
 RENOVA Vorë, Tiranë, Shqipëri | Tel.: 00355 48 301 909 | Fax: 00355 48 301 908 | renova.tirana@hotmail.com